

VENDIM

Nr. 72 , datë 13 . 11 . 2023

**“PËR MIRATIMIN E BASHKËFINANCIMIT TË PROJEKTIT ME TITULL  
“MBËSHTETJA DHE PLOTËSIMI INFRASTRUKTUROR I LABORATORËVE TË  
PRAKTIKËS PROFESIONALE PRANË FAKULTETIT TË SHKENCAVE  
MJEKËSORE TEKNIKE” NË KUADËR TË NDËRKOMBËTARIZIMIT TË  
PROGRAMEVE TË STUDIMIT, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024”**

Në bazë të ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Urdhrit nr. 287, datë 07.06.2023 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për shpalljen e thirrjes për financim e IAL-ve publike për projektet e përbashkëta në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit, për vitin akademik 2023-2024”, Urdhrit nr. 348, datë 10.07.2023 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për financim/bashkëfinancimin e projekteve të përbashkëta në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit, për vitin akademik 2023-2024”, Vendimit të Dekanatit të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike nr. 30, datë 13.09.2023, Vendimit të Rektoratit të UMT-së nr. 15, datë 25.09.2023, pasi mori në shqyrtim relacionin e dërguar me shkresën e Administratorit të UMT-së nr.2000/13 prot., datë 03.10.2023, Bordi i Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në mbledhjen e datës 13.11.2023,

VENDOSI:

1. Të miratojë Relacionin e Administratorit të UMT-së nr. 2000/13 për pjesën takuese të bashkëfinancimit në vlerën 2 190 000 (dy milion e njëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë për projektin me titull “Mbështetja dhe plotësimi infrastrukturor i laboratorëve të praktikës profesionale pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike”, në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit për Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
2. Efekti financiar mbulohet nga të ardhurat e veta, pjesë e buxhetit vjetor të miratuar në zërin “Kërkim shkencor” për Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së.

KRYETAR

ZAMIRA GJINI

ANËTARË

VERA OSTRENI

ALTINA XHAFFERI

MONIKA FIDA

ALBANA GJINOPULLI

ANIS THODHORJANI

ENDRIT YZEIRAJ